



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCES- VERBAL
Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Më datë 3 nëntor 2017, ora 11:15, në ambjentet e EU Info Centre – Tiranë, hapet takimi i anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së.

I pranishëm si përfaqësues i Kryeministrisë është z. Ergis SEFA ndërsa përfaqësuese e Bashkimit European është znj. Enkelejda Lopari.

Më tej, përfaqësues të Këshillit janë:

Znj. Emanuela ZAIMI;
Znj. Zana VOKOPOLA;
Znj. Aferdita SEITI
Znj. Mirela KOCI
Z. Vladimir THANO;
Z. Ali COKA;
Z. Ergys GEZKA;
Z. Blendi DIBRA.

Për AMShC- në:

Z. Andi KANANAJ;
Z. Erion BANUSHI;
Z. Andi LUGA;
Znj. Ina GJINI;
Znj. Mikela KAKELI.

Fjalën e hapjes e mori z. Ergis Sefa, ku parashtrroi qëllimin e takimit, i cili ka të bëjë me asistencën teknike nga BE për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, për disa masa në Udhërrëyes përfshirë mbështetje në disa fusha:

- Rishikimin afatmesëm të Udhërrëfyesit dhe hartimin e një plani të detajuar me tregues, buxhet dhe kornizë monitorimi për Udhërrëfyesin
- Mbështetje e organizatave të Këshillit Kombëtar në punë për t'u organizuar si një platformë si dhe për të punuar rreth prioriteteve sipas fushave
- Rekomandime dhe sugjerime për Kornizën ligjore dhe financare për shoqërinë civile
- Një vlerësim për mundësinë e një baze të të dhënave për shoqërinë civile.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Znj. Lopari u shpreh se kjo asistencë është një mundësi për të asistuar Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (dhe në veçanti anëtarët e shoqërisë civile) për të hartuar prioritet lidhur me tre fushat përkatëse të veprimit si dhe për t'i paraqitur në takimin e Këshillit.

Z. Ergis Sefa u shpreh se disa nga diskutimet prioritare që janë vënë re edhe nga qeveria mund të jenë diskutimet mbi çështjet financiare – fiskale si dhe ato për kuadrin rregullator. Ai shtoi se një nga problemet e hasura nga raportet e qeverisë është mosfunksionimi i KKSHC-së.

Z. Ergys Gezka, iu drejtua z. Ergis Sefa duke u shprehur se KKSHC-ja nuk është akoma e strukturuar, nuk ka akoma një rregullore përfundimtare, gjithashtu nuk është zgjedhur akoma kryetari dhe nënkryetari. Ai solli në vëmendje zgjedhjet që u mbajtën në qershor 2017 dhe ministrat teknikë në cilësinë e kryetarit të KKSHC-së nuk zhvilluan asnjë takim me antarët e Këshillit.

Z. Kananaj saktësoi për të pranishmit se AMSHC-ja luan rolin e sekretariatit teknik për KKSHC-në, dhe lehtëson nga ana logjistike, mbajtjen e takimeve. Iniciativat për propozime si për hartimin e rregullores dhe për zgjedhjen e nënkryetarit u takon antarëve të Shoqërisë Civile, gjithashtu të gjitha propozimet lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor, financiar dhe social për të mirën e shoqërisë civile.

Z. Sefa propozon se anëtarët e Shoqërisë Civile duhet të jenë këshillues më aktiv në lidhje me propozimet që duhet tu paraqesin qeverisë dhe të bien dakort për prioritetet në lidhje me takimet me ekspertët e BE.

Gjatë diskutimit u ngrit pyetja se si funksionon Udhëzuesi i BE-së për mjedisin mundësues dhe nëse ka hapësira për të ndryshuar disa tregues që ndoshta nuk përshtaten me kontekstin e Shqipërisë.

Znj. Lopari përgjigjet: “Korniza është një mjet që synon të mundësojë një dialog për fusha të caktuara dhe është e përgjithshme. Sigurisht që mund të ketë përshtatje lidhur me kontekstet e vendeve në varësi të mjedisit dhe prioritetëve. Kjo mund të diskutohet më tej në një takim specifik lidhur me këtë kornizë si dhe gjatë rishikimit të Udhërrëfyesit.”

Z. Kananaj u shpreh që në mbledhjen e ardhshme anëtarët e Shoqërisë Civile të vijjnë me dy apo tre propozime konkrete në mënyrë që të ketë hapësirë diskutimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Anëtarët e pranishëm te KKSHC-së kërkuan të qëndronin pas mbledhjes për të diskutuar mes tyre për realizimin e çështjeve të ngritura në mbledhje.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.